

1915
04.11.22

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A

Nr. 255 Prot.

Tiranë, më 03/11 /2022

Lënda: Propozim për përcaktimin e Portofoleve të Anëtarëve të Bursës që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në Tregjet e Ankandëve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Drejtuar: **Entit Rregullator të Energjisë**
Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimi”, Nr. 1023, Tiranë.

I nderuar z. Ahmeti,

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana e ALPEX-it për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të ALPEX, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, paraqet para Jush propozimin për përcaktimin e Portofoleve të Anëtarëve të Bursës që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në Tregjet e Ankandëve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

Ky propozim është dhënë duke marrë në konsideratë plotësimin e parashikimeve të Procedurës së Tregtimit të ALPEX sh.a, e cila është dërguar pranë jush me anë të shkresës Nr. 201 Prot. datë 29.08.2022 për miratim. Kjo Procedure parashikon në pikën B.1.6. Urdhërporositë Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje), duke lënë në diskrecion të Entit Rregullator të Energjisë përcaktimin e Portofoleve të Anëtarëve përkatës të Bursës të cilët do të dorëzojnë Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje).

Referuar Procedurës së Tregtimit të ALPEX, Urdhërporositë Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje) janë Urdhërporosi me hapa (Shitjeje/Blerjeje) të dorëzuara për një çmim të barabartë me Çmimin Maksimal/Minimal të Tregut të Ankandëve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë.

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra, tashmë në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, duke patur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e këtij funksioni, vlerëson se cilët prej Portofoleve të Anëtarëve të Bursës duhet të përfitojnë statusin për të vendosur Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje).

Duke marrë parasysh nevojën për një treg të drejtë dhe pa probleme në formimin e rregullt të kontratave, referuar praktikave të ndjekura nga Bursat e Energjisë të vendeve Evropiane, si dhe referuar procedurës së ndjekur nga Ofruesi i Shërbimit (Henex), Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a propozon miratimin nga ana Juaj të Portofoleve të Anëtarëve të Bursës dhe radhën e renditjes së tyre në kurbat e grupuara (Blerjeje/Shitjeje).

Portofolet e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Blerjeje, do të renditen sipas prioriteteve të mëposhtme:

1. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i Operatorit të Sistemit të Transmetimit SH.A për blerjen e humbjeve do të renditet e para në kurbën e grupuar të blerjeve.
2. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SH.A për blerjen e humbjeve do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të blerjeve.
3. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A për volumet sipas kontratës dypalëshe me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare SH.A në kuadër të detyrimit të shërbimit universal do të renditet e treta në kurbën e grupuar të blerjeve.
4. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i Palës Blerëse në kontratën dypalëshe (OTC – Over the Counter) që duhet të tregtohen në Bursë do të renditet e katërta në kurbën e grupuar të blerjeve.

Portofolet e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje sipas prioriteteve:

1. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i Operatorit të Burimeve të Rinovueshme (REO)/ Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A (FTL) për shitjen e energjisë që do të prodhohet nga prodhuesit me përparësi dhe që trajtohen me skema mbështetëse (Feed-in Tariff) do të renditet e para në kurbën e grupuar të shitjeve.
2. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare SH.A për shitjen e energjisë që do të prodhohet në rastet e shkarkimit të detyruar të kaskadës do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të shitjeve.
3. Sasia e energjisë së nominuar nga Portofoli i gjeneruesëve të BRE-ve që duhet të tregtohen në Bursë nga gjeneruesit që trajtohen me skema Kontrata për Diferencë (CfD) për shitjen e energjisë së prodhuar do të renditet e treta në kurbën e grupuar të shitjeve. Për këtë kategori nominimet me Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje nuk janë të detyrueshme, por një e drejtë që ata mund ta përdorin.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm.

ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a

Sokol Dishnica

